



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 1233/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Visar Ballovcit - Kandidat për Asamble Komunale (AAK) dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe komisionerëve nga KKZ-ja dega në Prishtinë, për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, në Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, morri këtë:

**VENDIM**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e Visar Ballovcit - Kandidat për Kuvendin Komunal në Prishtinë nga radhët e AAK-së .

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 03.12.2013 në ora 15:49 nga parashtruesi i ankesës Visar Ballovcit - Kandidat për Asamble Komunale ku pretendohet se, në VV1924E, 1925E mu janë manipuluar votat nga kryesuesit, komisionarët si dhe nga kandidatët për Asamble Komunale nga radhët e AAK-së, Rita Rafuna, Imer Rusinovci, Besa Rafuna, Gent Begolli, Fadil Arifi, Besime Sinanaj, prandaj kërkoi rinumërimin e votave në VV e lartpërmendura. Parashtruesi ankesës e ka bashkangjitur një fletëlist të dt. 03.12.2013 .

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

**ankesa është e pabazuar**

Me ankesën e parashtruar nga Visar Ballovcit - Kandidat për Asamble Komunale pretendohet se në, vendvotimet VV 1924E, 1925E janë manipuluar votat nga kryekomisioneri, komisionarët si dhe nga kandidatët për Asamble Komunale nga radhët e AAK-së, mirëpo një pretendim i tillë nuk mund të vërtetohet se është kryer një veprim i ndaluar.

PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë ankimorë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu vërtetuar, pasi që mungojnë prova bindëse me të cilat vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar, prandaj ankesa vlerësohet si e pa bazë, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 1233/2013 më datën 06.12.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Ferit Osmani**



***Këshillë Juridike:*** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.